

## **Pluralizmi politik në skanerin e një studiuesi të vërtetë**

**Dr. Lekë Sokoli**  
**Instituti i Sociologjisë**

(Botuar në "Tirana Observer, datë 7 dhjetor 2006)

Këto ditë u vu në qarkullim libri "Pluralizmi politik, përvoja dhe sfida" i prof. Servet Pëllumbit. Para se të them diçka për përmbajtjen dhe vlerat e librit, e gjykoj të nevojshme të them diçka për vetë autorin e tij. Aq më shumë që ai është në pragun e 70-vjetorit të lindjes.

Pra, kush është Servet Pëllumbi?

Ai është, së pari, një pedagog dhe studiues social. Ka kryer studimet e larta për filozofi, në San Petërsburg, në vitin 1960. Dhe, për më se 30 vjet, deri në vitin 1991, ka qenë pedagog i filozofisë dhe sociologjisë teorike në shkollat e larta, kryesisht në Universitetin e Tiranës. Ai është autor ose bashkautor i disa teksteve për shkollat e larta, i disa monografive, i "Fjalorit të filozofisë", në dy edicione, si dhe i një numri të madh artikujsh shkencorë e studimesh të botuara në revista shkencore brenda e jashtë vendit. Librat e tij më të fundit janë: "Dritëhijet e tranzicionit" (2000), "Të mendosh ndryshe" (2001), "Gjurmime sociologjike" (2002), "Sprovë në sociologjinë politike" (2002), "Edhe politika do moral" (2005). Ai është një ndër bashkëthemeluesit e Institutit të Studimeve Politike e Sociale (ISPS) dhe president i tij, sikurse ndër drejtuesit e botuesit e revistës shkencore "Politika & Shoqëria". Në mbledhjen themeluese të datës 21 nëntor 2006 ai u zgjodh kryetar i Bordit Akademik të Institutit të parë shqiptar të Sociologjisë.

Ai është, së dyti, edhe politikan. Madje një ndër politikanët më me emër të epokës së paskomunizmit. Është zgjedhur zëvendëskryetar i Partisë Socialiste të Shqipërisë në kongresin e themelimit të saj, në qershor të vitit 1991 (madje defakto, në 3-4 vjet, ishte kryetar i saj). Ka qenë deputet në disa legjislatura dhe kryetar i Kuvendit të Shqipërisë deri në zgjedhjet e 3 korrikut 2005.

Por e ndjej se duhet thënë diçka tej kronologjisë "së thatë" të jetës së tij shkencore e politike. Duke qenë ish-student i prof. Pëllumbit, në gjysmën e dytë të viteve '80-të. Më pas, si një ndër bashkëpunëtorët e tij të afërt në Institutin e Studimeve Politike e Sociale e në revistën "Politika & Shoqëria". Më tej akoma, si ndër bashkëthemeluesit dhe bashkëdrejtuesit e Institutit të parë të Sociologjisë. Për më tepër edhe si një ndër lexuesit e parë (madje edhe recensent) i librave të tij të këtyre viteve. Pra, diçka më shumë. Në rini ai mori një arsim solid, në një universitet të vërtetë. U formua si filozof, duke qenë i dhënë sidomos pas historisë së filozofisë. Madje u stërvit në analizën e shkollave të ndryshme të filozofisë botërore. Ai u zhyt shumë më shpejt se ne të tjerët në mendimin filozofik pluralist. Sepse e tillë ishte vetë filozofia.

Ai ishte ndër të paktët që, pavarësisht filozofisë zyrtare të kohës, pati rastin dhe mundësinë të studionte të gjitha shkollat e mendimit filozofik e sociologjik. Po të shfletojmë "Fjalorin e filozofisë", bashkautor i të cilit ai është, do të konstatojmë, madje pa shumë mundim, se në të janë të gjithë filozofët, siç janë të gjitha shkollat e filozofisë. Pra, ai ka kaluar në dorë, gjatë jetës së tij si pedagog e mësimdhënës, studiues e autor tekstesh apo librash të tjerë, veprat e filozofëve të mëdhenj. Ai ka ballafaquar idetë kryesore të tyre, pavarësisht tendenciozitetit të imponuar nga ideologjia zyrtare, paçka se "zakoni i kohës" e donte që, ndër shkollat e mendimit, të shpallej vetëm një fitues: marksizmi.

Ai që ndër të parët që zhvilloi lëndën e sociologjisë në shkollat tona të larta, pas një miratimi gjysmë zyrtar, në vitin 1986. Ai është, gjithashtu, studiuesi i parë shqiptar që mbrojtë doktoraturën në fushën e sociologjisë së përgjithshme.

Prof. Pëllumbi, nuk është një filozof apo sociolog marksist, apo kryesisht marksist, siç është perceptuar, paragjykuar apo keqgjykuar. Jo se është mëkat të jesh filozof apo sociolog marksist apo neomarksist. Në botën e sotme ata janë të shumtë. Madje nuk ka ndonjë tekst sociologjie për shkollat e larta, pa folur për botime të tjera, që të mos i referohet sociologjisë marksiste. Por, sepse në fakt Servet Pëllumbi është filozof pluralist. Ai njihet (sot për sot ndoshta si askush tjetër), çmon dhe vlerëson të gjitha shkollat e mendimit filozofik, ndër të cilat edhe marksizmin.

Por, pavarësisht njohjes së mëparshme, u desh "viti i madh 1989", siç shprehet ai në parathënien e librit, për një reflektim më të plotë e një pozicionim më të qartë. Që të kuptonte pa ndonjë hezitim vlerat e pluralizmit të mendimeve e ideve, madje edhe vlerat praktike të pluralizmit politik. Servet Pëllumbi, për më tepër, pati guximin të kërkonte zyrtarisht institucionalizimin e pluralizmit politik, siç dëshmon një letër e tij për Ramiz Alinë. Autori fjalën guxim e ka vënë për modesti në thonjëza. Por, në fakt, ishte vërtet guxim të kërkoje pluralizmin politik në një kohë kur shumë "demokratë" nuk besonin se komunizmi do të binte në të gjallë të tyre.

Në këtë kontekst, vetë tematika e librit nuk është e rastit. "Pluralizmi politik" nuk është një libër më shumë në bibliotekën e pasur të autorit. Edhe nëse nuk do të mbetet libri më i rëndësishëm i jetës së tij, të paktën ai duket se do të mbetet libri i tij më i dashur.

Janë disa arsye që e legjitimojnë botimin e këtij libri mbi pluralizmin politik.

Së pari, biblioteka shqiptare e filozofisë e sociologjisë politike është ende mjaft e varfër. Në gjykimin tim, ky është libri i parë tërësor me këtë problematikë.

Së dyti, edhe ato që shkruhen mbi politikën, pluralizmin, partitë dhe jetën e tyre të brendshme etj., vuajnë nga njëanshmëri të skajshme. Përkundrazi, libri në fjalë nuk ka kurrfarë njëanshmërie.

Së treti, ky është një libër tërësisht profesional, i bazuar në kriteret shkencore të studimeve sociale. Pra, nuk është një "sprovë", siç thuhet rëndom. Nga ana tjetër, autori e ka shkruar këtë libër pasi ka kaluar një jetë mbi libra (deri më 1990) dhe një jetë të dytë (pas vitit 1990), në politikën aktive, duke mos iu ndarë sërish librit dhe shkencës. Madje duke lëvruar, ndoshta si askush tjetër, disa nëndegë të shkencave sociale të lidhur drejtpërdrejt me pluralizmin, demokracinë dhe rregullat e lojës demokratike etj. Servet Pëllumbi është një ndër tranzicionalistët e parë, një ndër politologët e parë, një ndër partitologët e parë, sikurse një ndër lëvruesit e parë të sociologjisë së re politike të 15-20 vjetëve të fundit.

"Pluralizmi politik" është, më tej, libër i një autori me interesa shkencore. Ai është (nuk besoj ta teproj) njëfarë "abetareje", njëfarë manuali i terminologjisë së një fushe shumë të përfolur e pak të studiuar. Megjithëse ai vetë thotë pak a shumë të kundërtën, kur shkruan: "Në këtë libër të ri nuk i kam vënë vetes si qëllim përgatitjen e ndonjë manuali për pluralizmin politik, apo të shkruaj për historinë e tij...". Ai sqaron se të tjera shtysa e kanë vënë në lëvizje. Punën e tij ai e lidh, së pari, me motive të një rendi më praktik. Si pikënisje mund të merret "formula" se normaliteti i demokracisë dhe cilësia e jetës së qytetarit shqiptar, shkojnë në përpjestim të drejtë me funksionimin normal të "krahëve" të politikës pluraliste. Por ai vëren se në praktikë, përballë domosdoshmërisë për një pluralizëm politik funksionues, kundërqëndrojnë mjaft deformime. Disa mund të përligjeshin në vitet e para të tranzicionit, thotë ai, por kurrsesi në ditët e sotme. Sepse, ndër të tjera, ato ushqejnë deri edhe dyshimin në vlerat e vetë demokracisë. Ndaj papajtueshmërinë me këto deformime autori i "Pluralizmi politik" e konsideron si një mision i kohës.

Prof. Pëllumbi është, gjithsesi, kundër hyjnizimit të pluralizmit politik, i cili, sipas tij, nuk është një bibël, pra nuk ka "mundësi të pakufizuara". Ai, pa shprehur ndonjë parapëlqim të ndonjërës ndër alternativat e sotme pluraliste, mendon se siç ka rëndësi garantimi i një bote me shumë alternativa, ka rëndësi edhe respektimi i ndryshimeve midis tyre.

I pakënaqur me stadin e sotëm të zhvillimit demokratik (sikurse shumëkush ndër ne), ai mendon se është koha për të ngritur pluralizmin shumëpartiak në një stad të ri, në atë të funksionimit si sistem politik. Ai, mbështetur në metodologjinë disi specifike të politologjisë, nuk ngul këmbë në përshkrimin e fakteve, por në të kuptuarit, në interpretimin e tyre. Ai e merr faktin kryesisht nga realiteti politik shqiptar, por e analizon atë dhe, siç e kanë zakon sociologët e politikës, përgjithëson, i jep përmasat e një fakti shkencor. Ai u referohet edhe përvojës së vendeve të tjera dhe letërsisë së autorëve më me emër të politikës, madje nga Aristoteli e këtej.

Në këtë kuptim libri ka edhe vlera përgjithësuese, pra vlera teorike. Por ai ka vlera të veçanta praktike. Së pari, për studiuesit socialë. Së dyti, për ata që merren mirëfilltazi me politikë. Së treti, për lexuesin masiv, për publikun e gjerë. Autori "udhëton" në rrjedhat e pluralizmit politik shqiptar, duke filluar me kalimin nga monizmi në pluralizëm, vlerëson si "hile" të ashtuquajturin "pluralizëm socialist", analizon rrethanat historike dhe veçoritë e lindjes e vendosjes së tij në Shqipëri, raportet e pluralizmit politik me demokracinë, me filozofinë politike, me proceset globalizuese etj. Si një epilog logjik i këtij "udhëtimi" analitik, ai arrin në disa përfundime e rekomandime lidhur me të sotmen e të ardhmen, mbi tranzicionin (në aktet e fundit të tij) dhe pastranzicionin, mbi integrimin, sfidën e zhvillimit ekonomik etj.

Në mbyllje të analizës së tij, ai thekson nevojën e menaxhimit të pluralizmit politik e partiak. Ndryshe ai shoqërohet me dukuri atipike, si konfliktualiteti gangrenë, steriotipet, arroganca autoritariste, pazaret, klanet etj. Autori u drejtohet të gjithë atyre që kanë në dorë seleksionimin e "elitës politike" pa të cilën, siç pohon ai duke perifrastuar Ajshtajnin, bota do të bëhej një vend i rrezikshëm për t'u jetuar.

Prof. Pëllumbi na ka dhënë një libër të shkruar me merak të veçantë. Pas një përvoje të gjatë si politikan aktiv, por tanimë në njëfarë largësie të nevojshme për t'u çliruar nga "presioni" i politikës së ditës. Na ka dhënë një libër të këndshëm, të shkruar nga një "dorë e stërvitur". Ai na ka dhënë një libër shoqërisht të dobishëm. Le ta urojmë, së bashku i dashur lexues, e ta falënderojmë për këtë kontribut në të mirën tonë të përbashkët. Le t'i urojmë këtij profesori të filozofisë, sociologjisë dhe politikës: Jetë të gjatë e krijimtari të mbarë!